

Bartësi Privat i Arsimit të Lartë
Private Bearer of Higher Education



ALMA MATER EUROPAEA CAMPUS COLLEGE REZONANCA



Tel: +383 38 544-754

URL: <http://www.rezonanca-rks.com>

Nr.Prot. :	AD-1493/21-6
Datë :	31.03.2021

RREGULLORE E PUNËS SË SENATIT

**PRISHTINË
2021**

Në bazë të Statutit të Alma Mater Europaea Campus College Rezonanca, Senati i Kolegjit në mbledhjen e mbajtur më 31.03.2021 miratoi këtë:

Rregullore të punës së Senatit

I. PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e punës së Senatit të Kolegjit.
2. Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e thirrjes së mbledhjeve, kryesimi, mbajtja, mënyra e vendosjes, procedura e zgjedhjes dhe zbatimi i vendimeve.

Neni 2

Përbëria e Senatit

1. Senati është organi më i lartë akademik i Kolegjit përgjegjës për çështje akademike dhe kërkim shkencor në Kolegj.
2. Senati përbëhet nga këta anëtarë me të drejtë vote:
 - rektori,
 - 3 prorektorë (prorektori për mësim, prorektori për shkencë, prorektori për bashkupunim me jashtë dhe cilësi),
 - 3 dekanë të fakultetit (dekani i Fakultetit të Stomatologjisë, Dekani i Fakultetit të Farmacisë dhe Dekani i Fakultetit të Shkencave Mjekësore),
 - 1 përfaqësues i zgjedhur nga Departamenti i Shkencave Themelore Biomjekësore,
 - 1 përfaqësues i zgjedhur nga Departamenti i Shkencave Klinike,
 - 7 përfaqësues të departamenteve të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike,
 - 1 përfaqësues i zgjedhur nga Fakulteti i Stomatologjisë,
 - 1 përfaqësues i zgjedhur nga Fakulteti i Farmacisë,
 - 1 përfaqësues i zgjedhur nga stafi joakademik,
 - sekretari i Kolegjit dhe
 - 11 përfaqësues të zgjedhur nga Parlamenti i Studentëve.
3. Anëtarët nga Parlamenti i Studentëve zgjedhen prej radhëve të studentëve të rregullt të Kolegjit.
4. Studentët anëtarë të Senatit duhet të jene student te dalluar me note mesatare se paku tete (8), dhe nuk duhet të jenë përsëritës te vitit akademik.
5. Sekretari i Kolegjit është anëtar i përhershëm i Senatit, pa të drejtë vote.

Neni 3

Mandati i anëtarëve të Senatit

1. Mandati i anëtarëve akademikë dhe joakademikë të Senatit është katër vite.
2. Mandati i anëtarëve nga radha e studentëve është një vit, pa te drejte te rizgjedhjes.
3. Mandati i tyre fillon më 1 tetor.

Neni 4

1. Senatin e kryeson Rektori, në mungesë të tij, Senatin e kryeson prorektori të cilin e cakton rektori, sipas radhës.

Neni 5

1. Senati është përgjegjës për:
 - 1.1. Çështjet e përgjithshme strategjike që lidhen me kërkime, studime, mësimdhënie dhe kurset në Kolegj
 - 1.2. Miratimin e deklaratës së misionit të Kolegjit;
 - 1.3. Kriteret për pranimin e studentëve;
 - 1.4. Miratimin e propozimeve nga Këshilli i Fakultetit për zgjedhjen dhe avansimin e personelit akademik;
 - 1.5. Politikat dhe procedurat për vlerësimin dhe mbajtjen e provimeve për konstatimin e punës akademike të studentëve;
 - 1.6. Miratimin e përmbajtjes së planprogrameve;
 - 1.7. Sigurimin e mësimi tërë jetësor;
 - 1.8. Standardet akademike dhe validitetin dhe rishikimin e kurseve;
 - 1.9. Sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin;
 - 1.10. Procedurën për dhënien e kualifikimeve dhe të titujve akademikë të nderit;
 - 1.11. Procedurën për përjashtimin e studentëve për arsye akademike apo të tjera;
2. Zhvillimin e strategjisë për aktivitetet akademike në Kolegj dhe për mjetet e nevojshme për t'i mbështetur ato si dhe ofrimin e këshillave për rektorin dhe Këshillin drejtues;
3. Zhvillimin e politikës së mbrojtjes së pronësisë intelektuale të Kolegjit dhe shfrytëzimin komercial të saj;
4. Sigurimin e këshillave për çështje të tjera që Këshilli Drejtues ose rektori mund të kërkojnë nga Senati.

Neni 6

1. Detyrat e Senatit janë:
 - 1.1. Të aprovoj Statutin e Kolegjit, të propozuar nga Këshilli drejtues;
 - 1.2. Të zgjedhë anëtarët e Këshillit drejtues që propozohen nga Kolegji;
 - 1.3. Të formoj Komisionin profesional prej pesë (5) anëtarëve për propozimin e listës për rektor;
 - 1.4. Miraton propozimin e Këshillave të njëjësive akademike për zgjedhjen e dekanëve dhe prodekanëve;
 - 1.5. Të inicon procedurën për shkarkimin e dekanëve dhe prodekanëve sipas procedurës së caktuar me këtë statut;
 - 1.6. Të lëshojë vendime për pranimin dhe shuarjen e njëjësive akademike dhe të propozojë ndryshime të tjera në status të tyre për miratim nga ana e Këshillit drejtues;
 - 1.7. Të miratojë programet e studimeve të njëjësive akademike;
 - 1.8. Të përpilojë strategji për zhvillimin akademik të Kolegjit;
 - 1.9. Të nxjerrë rregullore të përgjithshme për fushat e punës arsimore, kërkimore dhe artistike;
 - 1.10. Të caktojë procedura dhe kritere për vlerësimin e mësimdhënies, punës shkencore dhe artistike;
 - 1.11. Të propozojë kriteret për regjistrimin e studentëve, në përputhje me këtë Statut dhe Ligjin mbi Arsimin e Lartë;
 - 1.12. Të vendosë për kriteret për përjashtimin e studentëve;
 - 1.13. Të definojë standardet akademike për ligjërata dhe për sigurim të cilësisë së mësimave, në pajtim me këtë Statut;
 - 1.14. Të përcaktojë përmbajtjen e të gjitha të dhënave akademike dhe dokumentacionit sipas këtij Statuti;
 - 1.15. Të vendosë procedurën për vlerësimin e personelit akademik në përputhje me këtë Statut;
 - 1.16. Të zgjedhë anëtarët për të gjitha komisionet dhe këshillat që i formon Senati;

- 1.17. Të marrë vendimet përfundimtare duke i marrë parasysh kundërshtimet e dhëna nga këshillat e njësive akademike;
- 1.18. Të vendosë për dhënien e titullit Dr. honoris causa;
- 1.19. Të vendosë për dhënien e titullit Profesor emeritus sipas dispozitave të këtij Statuti.
- 1.20. Të vendosë për dhënien e titullit Anëtar Nderi i Kolegjit;
- 1.21. Të shqyrtojë çështjet, me kërkesë të Këshillit drejtues apo rektorit;
- 1.22. Të shqyrtojë çështjet me propozim të Këshillit të njësive akademike;
- 1.23. Të shqyrtojë çështjet, me kërkesë të parlamentit të studentëve;
- 1.24. Të nxjerrë rregulloren e punës së Senatit;
- 1.25. Të shqyrtojë çështje të tjera siç përcaktohen nga ky Statut ose me kërkesën e Këshillit drejtues, rektorit, këshillave të fakulteteve ose Parlamentit Studentor.

Neni 7

1. Në mbledhjen e parë Senati verifikon mandatet e anëtarëve të Senatit.
2. Votimi i raportit bëhet në tërësi, nëse nuk është kontestuar asnjë mandat.
3. Nëse ka mandate të kontestuara, për këto mandate votohet veç e veç, pas votimit për mandatet e pakontestueshme.

Neni 8

1. Pas verifikimit të mandatit, anëtarët e Senatit e nënshkruajnë deklaratën etike lidhur me kryerjen me përgjegjësi dhe ndershmëri të detyrave.

Neni 9

Thirrja e mbledhjeve

1. Mbledhjet e Senatit, si të rregullta ashtu edhe të jashtëzakonshme i thërret dhe i kryeson Rectori.
2. Senati mban se paku dy mbledhje të rregullta, një në fillim dhe një në fund të semestrit përkatës.
3. Senati mund të mbajë më shumë mbledhje, varësisht nga nevoja.
4. Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të kërkohen edhe nga Dekanët ose nga së paku 1/3 e anëtarëve të Senatit. Këto mbledhje thirren nga rektori.
5. Të mbledhjet e jashtëzakonshme rendi i ditës kufizohet në një pikë kryesore.
5. Ftesa për mbledhje bëhet së paku tre ditë para mbledhjes. Ftesa mund të bëhet me shkrim, e-mail, ose në çfarëdo forme tjetër teknike me të cilën dërgesa dhe informimi janë të sigurt.
6. Ftesa për mbledhje përmban datën, kohën, vendin e mbajtjes së mbledhjes, si dhe rendin e ditës.
7. Tek anëtarët e Senatit me email përcjellët i tërë dokumentacioni për shqyrtim në mbledhje.

Neni 6

Pjesëmarrja në mbledhje dhe përfaqësimi

1. Në mbledhjet e Senatit kanë të drejtë dhe janë të obliguar të marrin pjesë të marrin pjesë të gjithë anëtarët e Senatit.
2. Në mbledhjet e Senatit anëtarët votojnë personalisht. Delegimi i votës nuk lejohet.
3. Mbledhjet e Senatit mbahen nëse marrin pjesë së paku 2/3 e anëtarëve të Senatit.

Neni 7

Fillimi i mbledhjes dhe miratimi i rendit të ditës

1. Pas verifikimit të numrit të anëtarëve pjesëmarrës në mbledhjen e Senatit dhe konstatimit se ka kuorum, Rektori e shpall të hapur mbledhjen e Senatit dhe propozon rendin e ditës për mbledhje.
2. Anëtarët e Senatit kanë të drejtë të propozojnë ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës, duke arsyetuar propozimin.
3. Miratimi i rendit të ditës bëhet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve prezent në mbledhje.

Neni 8

Ecuria e mbledhjes

1. Pas miratimit të rendit të ditës kalohet në shqyrtim dhe vendosje për ëështjet që janë në kuadër të pikave të aprovuara të rendit të ditës.
2. Raportimin dhe arsyetimin për secilën pikë të rendit të ditës e paraqet rektori, apo personi i caktuar nga rektori, pas të cilit hapet diskutimi.
3. Në diskutim mund të marrin pjesë të gjithë anëtarët e Senatit.
4. Fjala merret sipas radhës së paraqitjes për diskutim. Në mbledhje askush nuk mund të diskutojë pa e marrë fjalën nga rektori.
5. Për çdo pikë të rendit të ditës pjesëmarrësi mund të diskutojë më së shumti dy herë, herën e parë deri në pesë minuta dhe herën e dytë deri në dy minuta.
6. Rektori gjatë mbledhjes kujdeset për respektimin e Rregullores së punës së Senatit, si dhe sjelljet dhe veprimet e anëtarëve të Senatit konform kësaj Rregulloreje.
7. Rektori kujdeset që diskutimi të fokusohet në përmbajtjen e çështjes që është në shqyrtim.
8. Çdo pjesëmarrës që konsideron se lidhur me fjalën e tij është shtrembëruar ndonjë fakt, me lejen e rektorit mund të paraqitet për replikë, menjëherë pas përfundimit të diskutimit të pjesëmarrësit ndaj të cilit paraqitet replika. Replika lejohet për të njëjtën #ështje maksimalisht dy herë, në kohëzgjatje nga dy minuta.
9. Nëse për ndonjë anëtar të Senatit ekziston ndonjë konflikt i interesit, ai është i obliguar ta paraqes konfliktin e interesit.
10. Nëse Srenati nuk vendos ndryshe, anëtari në konflikt interesi duhet ta lëshojë mbledhjen gjatë kohës kur diskutohet kjo çështje.
11. Anëtari në konflikt interesi nuk ak të drejtë vote për çështjen përkatëse.
12. Rektori, sipas nevojës, ka të drejtë të ndërpres mbledhjen në kohëzgjatje prej 30 minuta. Me pajtim të Senatit kjo kohë e ndërprerjes mund të zgjatet.

Neni 9

1. Senati në bazë të propozimit të rektorit apo ndonjë anëtar të Senatit mund të vendosë që çështje të caktuara të shqyrtohen në mbledhjen e ardhshme pas përgatitjeve më të hollësishme të çështjes.

Neni 10

Vendosja, votimi dhe zgjedhjet

1. Vendimet e Senatit janë të plotëfuqishme nëse në mbledhje marrin pjesë së paku 2/3 e numrit të përgjithsëm të anëtarëve.

2. Pas shqyrtimit dhe përfundimit të diskutimeve Senati merr vendim ose konkluzion.
3. Porozimin e vendimit ose të kërkesës lidhur me atë pikë të rendit të ditës e formulon rektori.
4. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje.
5. Nëse ka më shumë propozime të vendimeve ose konkluzioneve, së pari votohet për propozimet e organeve të Kolegjit, e pastaj për propozimet tjera.
6. Votimi bëhet me vota të hapura ose me vota të fshehta. Për mënyrën e votimit vendos Senati në mbledhjen përkatëse.
7. Votimi bëhet: “Për, “Kundër, dhe “Abstenim”.
8. Në rast të numrit të votave të barabarta, propozimi konsiderohet i refuzuar.
9. Procedurën e votimit të fshehtë e zbaton komisioni i emëruar nga Senati i përbërë prej tre anëtarëve.
10. Në rast të pamundësisë për pjesëmarrje fizike në mbledhje, anëtari i Senatit mund të votojë përmes postës elektronike, me kusht që e-mail duhet t’iu shpërndalet të gjithë anëtarëve të Senatit.

Neni 11

Mbajtja e rendit në mbledhje

1. Për mbajtjen e rendit në mbledhje kujdeset rektori.
2. Për shkeljen e rëndë në mbledhje mund të shqiptohen këto masa:
 - a. Vërejtje, në rastet kur pjesëmarrësi me sjelljet dhe diskutimin e tij çrregullon dhe pengon punën normale të mbledhjes
 - b. Marrje e fjalës, në rastet kur pjesëmarrësi me sjelljet dhe diskutimin e tij çrregullon dhe pengon punën normale të mbledhjes, të cilit më parë i është shqiptuar vërejtje.
 - c. Largim nga mbledhja, i shqiptohet pjesëmarrësit nëse edhe pasi t’i merret fjala pengon mirëvajtjen e mbledhjes. Largimi bëhet vetëm për atë mbledhje.

Neni 12

Procesverbali nga mbledhja e Senatit

1. Për çdo mbledhje të Senatit mbahet procesverbali i mbledhjes. Procesverbali nënshkruhet nga Rektori dhe procesmbajtësi
2. Procesmbajtësi caktohet nga Rektori.
3. Procesverbali duhet të përmbajë: vendin, datën, kohën e fillimit dhe mbarimit të mbledhjes, rendin e ditës, listën e pjesëmarrësve në mbledhje, të gjitha propozimet, vendimet, konkluzionet e mbledhjes
4. Dokumentat shtesë duhet t’i bashkangjiten procesverbalit.
5. Procesverbali përgatitet brenda një jave pas mbledhjes së Senatit dhe si ekstrakt duhet t’iu dërgohet anëtarëve të Senatit me rastin e dërgimit të materialit për mbledhjen e ardhshme të Senatit.
6. Procesverbali miratohet në mbledhjen e radhës së Senatit.
7. Procesverbali ruhet në arkivën e Kolegjit me materialet e shlytuara sipas rendit të ditës, si dokumenta afatgjata.

Neni 13

Komisionet

1. Senati mund të formojë këshilla ose komisione të përkohshme për ta këshilluar atë lidhur me aspekte të veçanta të punës së tij.

Neni 14

Aktet e Senatit

1. Senati nxjerr: Rregullore, Vendime, Konkluzione dhe Rekomandime.
2. Senati jep interpretim autentik të akteve që i miraton.
3. Procesmbajtësi i përgatitë vendimet, konkluzionet dhe rekomandimet, kurse rregulloret i përgatit komisini përkthës.

Neni 15

1. Për të gjitha çështjet që nuk janë përfshirë në këtë rregullore do të zbatohen dispozitat e Statutit dhe Ligjit mbi Arsimin e Lartë Nr. 04/L-037.

Neni 16

Dispozitat përfundimtare

1. Për zbatimin e kësaj Rregulloreje kujdeset rektori, si kryesues i Senatit.
2. Interpretimin autentik të kësaj Rregulloreje e jep Senati.
3. Rregullorja hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Senati.
4. Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj Rregulloreje mund të bëhet sipas të njëjtës procedurë të miratimit.

Kryesuesi i Senatit

Acad.Prof.dr. Arian Idrizaj - Rektor